



Republika e Kosovës  
Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës  
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



## DREJTORIA E PRONËS KADASTRIT DHE GJEODEZISË

Bazuar në nenin 62.3shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenin 17.2 të Ligjit për dhënien në shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 17 paragrafi 2.3 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenin 64.4 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, bënë këtë:

### NJOFTIM PUBLIK

Njoftohen përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile – OJQ-ve lokale që të bëjnë propozimet e anëtarëve të tyre për plotësimin e përbërjes së Komisioneve që do të ngritën në Kuvendin e Komunës së Podujevës dhe atë;

***Komisione ad-hoc vlerësuese për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për njësitë kadastrale në vijim:***

- **Njësitë kadastrale ; P-71712027-00706-0 dhe P-71712027-00704-0** me sipërfaqe të përgjithshme 9937m<sup>2</sup> të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Llapashticë e Poshtme nga kjo sipërfaqe jepen në shfrytëzim 5500 m<sup>2</sup> në vendin e quajtur “Ara nën Vorreza” me shfrytëzim aktual kullosë , me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Shfrytëzim i Përziër dhe Bujqësore.
- **Njësitë kadastrale;** Lokali afarist me sipërfaqe 50 m<sup>2</sup> dhe Lokali afarist me sipërfaqe 55 m<sup>2</sup> të ndërtuara në njësinë kadastrale **P-71712062-00459-0** me sipërfaqe 2237m<sup>2</sup> Zona Kadastrale Podujevë, në vendin e quajtur “ Qytet-Rr.Skenderbeu” me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Zonë Ndërtimore.
- **Njësia kadastrale ; P- 71712029-202-3** e cila gjendet në Zonën Kadastrale Lupç i Poshtëm me sipërfaqe prej 137157 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “Bugurdoll- Bugurdoll”,shfrytëzimi aktual i parcelës kullosë , me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Zonë Bujqësore.
- **Njësia kadastrale ; P-71712058-1339-0** e cila gjendet në Zonën Kadastrale Orllan me sipërfaqe prej 2106m<sup>2</sup>, nga kjo njësi kadastrale sipërfaqja e planifikuar për dhënje në shfrytëzim është 1250m<sup>2</sup> duke përfshirë objektin hotelier prej 250m<sup>2</sup> në vendin e quajtur “Fshat-Orllan” me shfrytëzim aktual oborr , shtëpi-ndërtesë me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale zonë e dytë e mbrojtur.

Në kuadër të Komisioneve në fjalë do të përfshihet nga një anëtar i sektorit jo qeveritar lokal.

Personat e nominuar për Komisionet e cekura, ndër të tjera, duhet t'i dorëzojnë; CV e tyre si dhe një Letër Interesim – rekomandim për pjesëmarrje në këto Komisione, ku prezantohen arsyet e nominimit.

Përzgjedhja e përfaqësuesve bëhet me votim në Kuvendin e Komunës.

Afati për aplikim është nga data 24.03.2026 deri më 30.03.2026, brenda orarit zyrtar të punës, dhe të njëjtat bëhen përmes Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

Propozimet gjithashtu mund të dërgohen edhe përmes postës elektronike zyrtare, në emailin;  
[dpgkj.podujeva@rks-gov.net](mailto:dpgkj.podujeva@rks-gov.net)  
[ardiana.dibrani@rks-gov.net](mailto:ardiana.dibrani@rks-gov.net)

Nr.Pro: 08-020/04-00.16731/26  
Datë 24.03.2026



Drejtoresha  
Saranda Stublla